

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A- 018/14

Prishtinë,
2 Dhjetor 2014

Në çështjen juridike të:

V. V.

Përfaqësuar nga:

S.Đ.,

Pala ankuese

kundër

I panjohur

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Willem Brouwer , Kryesues i Kolegjit, Esma Erterzi dhe Sylejman Nuredini anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/199/2013 lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA06077 i datës 2 Dhjetor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 23 Korrik 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e palës ankuese kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/199/2013, e datës 18 prill 2013.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/199/2013, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA06077, i datës 18 prill 2013.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 22 dhjetor 2006, V. V. ka paraqitur kërkesë, duke kërkuar vërtetimin e të drejtës pronësore për ngastrën me nr. 951/1 me sipërfaqe 00.04.68 ha (këtëj tutje prona) e përbërë nga një shtëpi dhe oborr, që ndodhet në komunën e Pejës, zona kadastrale Vitomiricë.
2. Gjatë procedimit të kërkesës, ajo ka paraqitur, *inter alia*:
 - Aktvendimin e trashëgiminë T.Nr..23/73 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Pejës, me datën 27 shkurt 1974 ku konstatohet se V. V. është shpallur trashëgimtare e vetme e pronës. Ajo ka trashëguar pronën nga e ndjera nëna e saj, M. V..
 - Kontratën për mbajte të përhjetshme Nr. 515/95 të datës 21 nëntor 1995 të certifikuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë e lidhur në mes të V. V. dhe mbesës së saj S. Đ. për bartjen e të drejtës pronësore të pronës së kërkuar pas vdekjes së saj tek mbesa e vet.
 - Fletën poseduese nr. 231, të lëshuar nga Instituti Gjeodezik i Serbisë, Qendra për Kadastër të Pronës së Paluajtshme në Pejë me datë 25 korrik 2005. Sipas fletës poseduese prona ishte në pronësi të V. V..
 - Autorizimin e datës 30 Maj 2008 ku konstatohet se V. V. e ka autorizuar mbesën e saj S.Đ., për ta përfaqësuar para AKP-së.
 - Çertifikatën e vdekjes që tregon se V. V. ka vdekur me 16 maj 2009.
3. Njoftimi i kërkesës është bërë me 27 janar 2011, i cili paraqet pronën si një oborr (shtëpia ishte krejtësisht e shkatërruar), të pa uzurpuar.

4. Nga provat në shkresat e kërkesës vërehet se për pronën e njëjtë ishte paraqitur një kërkesë tjetër para AKP së nga S.V. (nipi i paraqitëses së kërkesës), i cili kërkon ri-posedimin e pronës duke pretenduar se ai është bashkëpronar legjitim i 1/3 pjesë ideale të pronës.
5. Në mbështetje të kërkesës së tij S. V. ka paraqitur aktgjykimin e formës së prerë C.Br.716/98 të datës 09 shkurt 1999 në Gjykatën Komunale të Pejës (në tekstin e mëtejme i referuar si: aktgjykimi 1999) ku konstatohet se S. V. dhe vëllezërve të tij i njihet e drejta e bashkëpronësisë ndaj, secilit me nga 1/3 pjesë ideale dhe fletën poseduese nr. 231 të lëshuar nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara, Departamenti për Kadashtër, Gjeodezi dhe Pronë, Komuna e Pejës, zona kadastrale Vitomicë, që evidenton pronën të regjistruar në emër të tre bashkëpronarëve mes tyre S. V.
6. Sipas raportit verifikues të AKP-së, i datës 4 shkurt 2013, prona është e regjistruar në emër të tre bashkëpronarëve B, M. dhe S. V., vëllezërit e palës ankuese. Certifikata për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme është azhurnuar në vitin 2003 sipas aktgjykimit Nr.Br.716/98 të vitit 1999 i cili tashmë është prezantuar në kërkesë të paraqitur nga S.V. Gjykata Supreme, ex officio, e ka kërkuar aktgjykimin e lartpërmendur.
7. Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së ka kontaktuar me palën ankuese më 26 mars 2013 për ta informuar se prona e kërkuar është regjistruar në emër të vëllezërve të saj në cilësinë e bashkëpronarëve. Pala ankuese ka thënë se kontesti aktual i pronës ka të bëjë vetëm me tre vëllezërit e saj për të cilët ajo pretendon se e kanë falsifikuar aktgjykimin e vitit 1999 dhe provat e ndërlydhura me qëllim të regjistrimit të pronës në emër të tyre.
8. Pala ankuese si dokumente shtesë ka paraqitur:
 - Kallëzim Penal të datës 31 gusht 2012 për mashtrim bazuar në nenin 335 të Kodit Penal të Kosovës , kundër tre bashkëpronarëve e parashtruar në Prokurorinë Komunale të Pejës,
 - Kërkesë pranë Gjykatës Komunale në Pejë e datës 12/10/2012 për caktimin e masave të përkohshme, siç është, pezullimi i të drejtës së bashkëpronarit për të disponuar me pronën.
9. Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së ka kontaktuar gjithashtu me S. V. i cili pohon se ai dhe vëllezërit e tij kanë qenë në posedim të pronës deri në periudhën e konfliktit si dhe gjatë periudhës kur prona ishte regjistruar në emër të paraqitëses së kërkesës, V.V.. S. V. ka shpjeguar se paraqitësja e kërkesës së bashku me babain e tij kanë pasur një marrëveshje për ta shpallur paraqitësen e kërkesës si pronare të vetme të pronës vetëm formalisht. Pasi që paraqitësja e kërkesës ka refuzuar t'ia bart të drejtën e pronës siç është pajtuar më parë me babain e S.V., ky i fundit ka iniciuar në kontest civil kundër paraqitëses së kërkesës i cili ka përfunduar më aktgjykimin në favor të tij dhe të vëllezërve të tij.
10. KKKP-ja me vendimin KPCC/D/R/199/2013 më 18 prill 2013 ka vendosur se kërkesa duhet të hidhet poshtë meqë paraqitësja e kërkesës ka dështuar të dëshmojë se kërkesa e saj

përshinë rrethanat që ndërlidhen drejtpërdrejt ose që rezultojnë nga konflikti 1998-1998 prandaj kërkesa është jashtë juridiksionit të KKKPK-së.

11. Vendimi i KKKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 19 gusht 2013. Ajo ka paraqitur ankesë më 11 shtator 2013.

Pretendimet e palës ankuese

12. Pala ankuese deklaron se vendimi i KKKPK-së është i bazuar në shkelje të së drejtës procedurale dhe materiale, si dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
13. Pala ankuese pretendon se kërkesa e të ndjerës V. V. është hedhur poshtë siç është specifikuar në nenin e parë të vendimit KPCC/D/R/199/2013, ndërsa neni i dytë i vendimit thotë se prona është uzurpuar më mënyrë të paligjshme, dhe se vendimi i mësipërm nuk parashihet asnjë të drejtë për palët përgjegjëse në kërkesë apo poseduesin aktual.
14. Pala ankuese thekson se ajo asnjëherë nuk është kontaktuar nga ndonjë zyrtar i AKP-së, me qëllim të sqarimit të situatës, dhe se ajo i ka paraqitur të gjitha provat e nevojshme që vërtetojnë të drejtën pronësore të saj ndaj pronës në fjalë.
15. Pala ankuese beson se AKP-ja, pa prova, në mënyrë arbitrare dhe krejtësisht subjektive, hedh poshtë të gjitha kërkesat e serbëve; ndër të tjera, kërkesa e paraqitur nga V. V me qëllim që ti lë trashëgimtarët e saj pa prona të cilat ajo i ka gëzuar deri në qershor të vitit 1999.
16. Vendimi i KKKPK-së, i pambështetur nga ndonjë provë dhe i marrë siç është përshkruar, paraqet shkelje të ligjit vendor dhe ndërkombëtar, i cili është i zbatueshëm drejtpërdrejtë sipas kushtetutës së Kosovës, sepse paraqitësja e kërkesës përmes dokumentacionit të bashkëngjitur në kërkesë, ka vërtetuar se ajo është pronare e vetme dhe ekskluzive e pronës.

Arsyetim ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

17. Ankesa është paraqitur brenda afati prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, (në tekstin e mëtejme Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50). Gjykata Supreme ka juridiksion ndaj ankesave kundër vendimit të KKKPK-së. Ankesa është e pranueshme.

Meritat e ankesës

18. Çështja për tu marr në konsideratë në këtë rast është nëse KKPK-ja ka pasur juridiksion të shqyrtojë kërkesën e paraqitëses së kërkesës të paraqitur në AKP në vitin 2006.
19. Lidhur me pretendimin e palës ankuese së vendimi i KKPK-së është i paqartë, KKPK-ja ka marrë një vendim të vërtetuar më 18 prill 2013, vendimi i është referuar “paragrafëve përkatës” të Vendimit Grupor. Një referim i veçantë i është bërë paragrafëve 9 dhe 23. Prandaj, Gjykata Supreme do të bëjë një përmbledhje të shkurtër të arsyeve se pse KKPK-ja nuk ka juridiksion për këtë lëndë.
20. Sipas Nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër të Komisionit për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e dëshmon të drejtën pronësore por edhe që ai apo ajo tani nuk është në gjendje të ushroj të drejtat ndaj asaj prone për shkak të rrethanave që direkt ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.
21. KKPK-ja hodhi poshtë kërkesën në bazë të mungesës së juridiksionit për të vendosur mbi meritat e kërkesës, pasi që paraqitësja e kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë se kërkesa e saj përfshin rrethanat që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo janë pasojë e konfliktit të armatosur të periudhës 1998-1999.
22. Në këtë drejtim, fillimisht, Gjykata Supreme ka vërtetuar se paraqitësja e kërkesës asnjëherë nuk e ka poseduar pronën para konfliktit të armatosur. Provat e dorëzuara nga ajo (Autorizimi, çertifikata e vdekjes) i referohen Prishtinës si vendbanim i paraqitëses së kërkesës. Pala ankuese ka konfirmuar shprehimisht në akuzat penale se ajo dhe paraqitësja e kërkesës kanë jetuar në Prishtinë deri në qershor të vitit 1999.
23. Për më tepër S. V., vëllai i palës ankuese ka paraqitur kërkesën për të njëjtën pronë duke kërkuar ri-posedimin. Pala ankuese është informuar nga KPA ja rreth kërkesës dhe ajo kishte konfirmuar se kontesti aktual pronësor ka të bëjë vetëm më vëllezërit e saj. Është e qartë nga dokumentet dhe deklaratat në dosjen e AKP-së se kontesti familjar lidhur me të drejtën e pronësisë për pronën në fjalë ka filluar shumë më herët se shpërthimi i konfliktit të armatosur i periudhës 1998/1999.
24. Pala ankuese, ndonëse pretendon se Pretendimet e palës ankuese së vëllai i saj e ka falsifikuar aktgjykimin e Gjykatës Komonale të vitit 1999 dhe provat e ndërlidhura me qëllim të regjistrimit të pronës në emrat e tyre, nuk paraqiti prova ligjore në mbështetje të pretendimeve të saj. Kontesti as nuk është shkaktuar e as ndikuar nga lufta, por buron drejtpërdrejtë nga kontesti pronësor ndërmjet anëtarëve të familjes V. Prandaj, kërkesa është jashtë juridiksionit

të AKP-së dhe KKPK-së. Konkludimi i KKPK-së ka qenë i saktë kur e ka hedhur poshtë kërkesën për shkak të mungesës së juridiksionit.

25. Kjo ngase faktet e verifikuara dhe provat e administruara dëshmuar se paraqitësja e kërkesës as nuk e ka braktisur pronën e kërkuar e as nuk e ka humbur posedimit e saj për shkak të konfliktit apo si pasojë e rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo burojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet viteve 1998/1999.
26. Rrjedhimisht, në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ankesa është refuzuar si a pabazuar dhe është konfirmuar vendimi i KKPK-së për aq sa ndërlidhet me lëndën për të cilën është vendosur me këtë aktgjykim (AKP 06077).

Këshillë ligjore

27. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Willem Brouwer , Kryetar i Kolegjit i EULEX-it

Esma Erterzi, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini , Gjyqtar

Urs Nufer , Referent i EULEX-it